LIGJ
Nr. 70/2020

PËR MIRATIMIN E HUAMARRJES PREJ 139 300 000 SDR-sh QË FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR I AKORDON SHQIPËRISË NËPËRMJET INSTRUMENTIT TË FINANCIMIT TË SHPEJTË (RFI)

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 156 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet huamarrja prej 139 300 000 SDR-sh që Fondi Monetar Ndërkombëtar i akordon Shqipërisë nëpërmjet Instrumentit të Financimit të Shpejtë (RFI), me termat, sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 28.5.2020

Shpallur me dekretin nr. 11512, datë 16.6.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

ANEKSI I

Termat e huas paraqiten si vijon:

Shuma e huas 139,300,000 SDR

Norma e interesit përbëhet nga (i) një normë bazë (e përcaktueshme nga tregu [0.05% javën që përfundon në 10 prill]) plus një marzh të caktuar nga Bordi Drejtues çdo dy vjet (aktualisht 100 bps); (ii) tarifën shtesë të bazuar në nivelin prej 200 bps mbi stokun e kredisë mbi 187.5% të kuotës; dhe (iii) tarifën shtesë të bazuar në kohë prej 100 bps, kur shuma e stokut të kredisë qëndron mbi 187.5% të kuotës për më shumë se 36 muaj.

Instrumenti që i akordohet Shqipërisë ka një normë huadhënie, që do të përfshijë normën bazë të interesit në SDR (0.05%), një marzh të vendosur nga Bordi Drejtues (1%), tarifën shtesë të bazuar në nivel prej 2%, dhe një tarifë shtesë të bazuar në kohë prej 1%, duke e çuar normën totale të instrumentit në 4.05%.

Komisioni i shërbimit aplikohet mbi çdo shumë që tërhiqet nga huaja dhe është 0.5% (50 bps).

Maturimi i huas 3¼ deri në 5 vjet.